



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr. 192/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore Sh.a, me seli në rr.“Xhevdet Doda”, nr. 32, Prishtinë, kundër debitorit Pizzeria “Aroma” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, me pronar A.K., duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.164/22 të datës 18.08.2023, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë , ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.164/22 të datës 18.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.164/22 të datës 18.08.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka pranuar si të bazuar prapësimin Pizzeria “Aroma” Sh.p.k, ashtu që ka anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 178/18 i datës 12.12.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Shala.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.164/22 të datës 18.08.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë, me dt. 14.12.2018 ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit: Faturë kthyesë me nr. 2018/4276 dhe kartelës financiare të datës 04.12.2019 të lëshuar nga kreditori, ashtu që është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara në emër të qirasë së lokalit, t'ia paguajë kreditorit shumën prej 8,156.66 EUR (tetëmijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e gjashtë euro cent) me kamatëvonesë prej 8% në vit duke e llogaritur nga dita e dorëzimit të përmbartimit deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e përmbartimit të gjitha këto brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin përmbartimor.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri përmbartimor nuk paraqet titull ekzekutiv, kjo pasi që në faturën nr. 2018/4276 është tjetër shumë e obligimeve ndërsa në kartelën financiare shumë tjetër ashtu që nuk dihet saktë borxhi që kërkohet. Tutje ka shtuar se kreditori është i njoftuar se lidhur me lokalin për të cilën kërkohet qiraja nga kreditori, debitori ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë pasi që i njëjti është ngarkuar me qira edhe për periudhën kohore për të cilën nuk e ka shfrytëzuar lokalin si dhe debitori ka kërkuar kompensimin e dëmit edhe në emër të investimeve. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Kreditori në përgjigje ndaj prapësimin ka theksuar se dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi paraqesin bazë për lejimin e përmbartimit dhe janë të përshtatshme për përmbartim. Ka shtuar se debitori nuk ka bërë asnjë pagesë të vetme në emër të shfrytëzimit të lokalit, ndërsa i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë për të argumentuar një nga shkaqet ligjore për anulimin e urdhrin përmbartimor. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i ushtruar kundër urdhrin përmbartim të refuzohet dhe urdhri për lejimin e përmbartimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.164/22 të datës 18.08.2023, ku në pikën e parë të dispozitivit ka pranuar si të bazuar prapësimin Pizzeria “Aroma” Sh.p.k, ashtu që ka anuluar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 178/18 i datës 12.12.2018, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Isak Shala.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se dokumenti faturë nr. 2018/4276 nuk është e përshtatshme për përmbarrim për shkak të të metave në objektin e detyrimit të saj, ndërsa kartela financiare e datës 04.12.2018 nuk paraqet dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë Gjykata vendosi që urdhri për lejimin e përmbarrimit të shfuqizohet.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim nga shkresat e lëndës dokumentet mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk i plotësojnë kushtet që të konsiderohen dokument i besueshëm, ashtu siç përcaktohet me nenin 29 të LPP-së, “1. Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, 3 sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokument i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbarrjes së detyrimit monetar”, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se fatura nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nga kjo faturë nuk mund të vërtetohet se për cilën periudhë kohore është kërkuar borxhi, andaj shërbimi i përshkruar në këtë faturë nuk

përputhet me borxhin total i cili kërkohet sipas të njëjtës. andaj më të drejtë ka vendosur Gjykata e Shkallës së Parë.

Ndërsa sa i përket kartelës financiare e dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm ngase në kuadër të dokumenteve të besueshme janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste vetëm sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave. Andaj duke marr parasysh faktin se në rastin konkret propozimi për përmbarrim është lejuar sipas një dokumenti – kartelës financiare në kuadër të Ndërmarrjes Publike Banesore, gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm. Po ashtu borxhin në shumë prej 8,158.66 EUR, shumë kjo që nuk përputhet me shumën e evidentuar në faturën nr. 2018/4276 cila përmban vlerën totale prej 25,172.27 EUR

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Andaj qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me gjendjen faktike rezultojnë si të pathemelta të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi që ta vërtetojë.

Përndryshe në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.192/24 me datë 24.04.2024**

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti